

ENGJËLLUSHE KARAJ

**RRETH FJALËVE TË HUAJA ME FUNKSION SHPJEGUES TE
FJALORI I GJUHËS SHQIPE I ALEKSANDËR XHUVANIT**

Aleksandër Xhuvani mbetet një nga njohësit më të mirë të visarit leksikor të gjuhës shqipe. Një nga drejtimet e punës së palodhshme disadhjetëvjeçare të tij është puna me fjalën shqipe, dhe sidomos puna leksikografike. Ai ka punuar me pasion, si rrallëkush tjetër, duke ecur në shtigjet e hapura nga K. Kristoforidhi për mbledhjen e fjalës shqipe, sidomos drejtpërdrejt nga goja e popullit. A. Xhuvani punoi për një kohë të gjatë me këmbëngulje, me përkushtim dhe profesionalizëm për të grumbulluar e vjelë fjalë të shqipes dhe donte të hartonte një fjalor, duke dashur ta quante *Kristoforidhi i vogël*. Vlerat e tij do të ishin me të vërtetë të shumta. Xhuvani nuk pati kohë të shkojë përtej fazës regjistruese të parë të materialeve. Ai nuk arriti të bëjë përpunimin e tyre, as verifikimet, plotësimet e nevojshme apo sistemimin, sa ishte gjallë.

Prof. Aleksandër Xhuvani synonte të hartonte dhe të botonte *Fjalorin e gjuhës shqipe*, me rreth 14500 fjalë, të mbledhura këto në të gjithë Shqipërinë, madje në të gjitha viset e banuara nga shqiptarë, si dhe të mbledhura në veprat e autorëve të vjetër. Këto fjalë do të jenë një burim i vlefshëm për pasurimin e fjalorëve të shqipes edhe me lëndë nga pasuria gjuhësore dialektore.

Pjesa dërrmuese e pasurisë që ishte grumbulluar prej tij, u përzgjedh dhe u botua nën kujdesin shkencor e redaktorial të profesorëve Mahir Domi dhe Qemal Haxhihasani në revistën shkencore *Studime filologjike* për disa vjet rresht, në rubrikën *Materiale dhe dokumente* me titullin: *Fjalë dhe shprehje të shqipes* (duke nisur nga numri 1971/4 - 1990/2, pra në 52 numra të saj).

Në faqet e revistës *Studime filologjike* janë botuar materialet leksikore, frazeologjike dhe semantike që lidhen me shkronjat: A, B, C, Ç, D, DH, F, G, GJ, H, L, LL, M, N, Nj, O, P, Q, R, RR, S, SH, T, TH, U, V, X, Xh, Y, Z, Zh. Pra, nuk ishte i gjithë materiali. Menduam se nuk kishte asnjë mundësi që leksikografi i njohur të mos kishte mbledhur fjalë që lidheshin me shkronja si K, E, I, J, Ë. Për këtë arsye, vazhduam kërkimet dhe pas disa përpjekjesh u gjetën skedat edhe për këto shkronja që mungonin, me një volum prej 40 faqesh (A4). Edhe ato u futën në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të Aleksandër Xhuvanit¹. Mbeten akoma për t'u hedhur në kompjuter rreth 2600 skeda të

¹ *Fjalori i gjuhës shqipe* i A. Xhuvanit është pjesa e dytë e punimit të mikrotezës së masterit me temë: "Për një botim të plotë të Fjalorit të gjuhës shqipe të A. Xhuvanit" (Engjëllushe Karaj). Për hartimin e këtij Fjalori janë shfrytëzuar numrat 1971/4 – 1990/2 të revistës *Studime filologjike*, si dhe fondi i A. Xhuvanit në Kartotekën e Leksikut të Shqipes.

tjera që u gjetën më vonë dhe që i përkasin kryesisht shkronjës K. Nuk dihen akoma arsyet se përse këto shkronja nuk janë botuar në revistë.

Në Fjalor vihet re se shpjegimet e fjalëve janë dhënë në mënyra të ndryshme. Ne jemi përqendruar në këtë punim të thukët te përqasjet e fjalës shqipe me ato të disa gjuhëve të huaja.

Një fjalor njëgjuhësh vlerësohet edhe për *shpjegimet kuptimore*, të cilat gjuhësisht na çojnë të nocioni për frymorin, për sendin, për dukurinë, për veprimin, tiparin, rrethanën etj. Struktura kuptimore e një fjale na çon te kuptimi (nëse është njëkuptimëshe) ose tek të gjitha kuptimet e saj (nëse është shumëkuptimëshe), të cilat renditen së pari sipas rëndësisë, sipas prejardhjes, sipas vlerës në gjuhën e sotme, sipas tipit të kuptimeve. Studiuesi J. Thomai thekson se qëllimi i shpjegimit të kuptimit është që të na lidhë me realen që shënon fjala në atë kuptim, ta identifikojë dhe ta dallojë nga realiteti e tjera të ngjashme me të. Kjo ka vlerë sidomos për fjalorët dialektorë, sepse shumica e tyre, janë hartuar nga dashamirës të gjuhës shqipe dhe të pasurisë së saj leksikore e frazeologjike².

Rasti i Fjalorit të A. Xhuvanit është paksa ndryshe. Edhe pse është fjalor njëgjuhësh, në të gjen edhe përqasje me gjuhët e tjera. Kjo ndodh pasi, në kohën kur ai i mbodhi këto fjalë për të bërë një fjalor, i cili do të mbushte boshllëqet e fjalorëve të tjerë dygjuhësh, mungonin fjalorët njëgjuhësh.

Cilat janë gjuhët e huaja që Xhuvani ka përdorur në Fjalor?

Në *Fjalorin e gjuhës shqipe* të Aleksandër Xhuvanit vihet re një larmi përqasjesh me gjuhët e tjera. Në këtë kuadër do të rendisim shembuj nga gjuhët e përdorura si dhe shpeshësinë e përdorimit të tyre:

- Italishtja zë vendin e parë, me rreth **940** përqasje. P.sh.:

athun ndf. kot; **it. in vano**³.

andej pfj.: **andej** detit, **it. di là del mare**; **andej** malit.

rrip/ë-a ef. tokë e përpjetë, fr. escarpement, **it. luogo dirupato, scosceso**; vend i pjerrët, i varur, shpat, përpjetësinë pa bimë, vetëm gur e dhe; me ato bri ma të shumtën rripë, **it. ripido**: jemi buzë rripës e po humbasim; greminë: rripë e thellë, e tmeruarë (S. Frashëri). FGJSH f. 477.

- Frëngjishtja, me rreth **890** përqasje. P.sh.:

atëhere ndf. 1. atëbotë, asaj kohe; 2. prapë, **fr. par conséquence**.

zustër-a ef. rrebe, tekë: **mos ban** zustra (S. Kolea), **fr. caprice**.

² J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006, f. 311.

³ Shembujt janë marrë nga *Fjalori i gjuhës shqipe* i Aleksandër Xhuvanit, por duhet theksuar që nuk janë bërë korrigjime (materiali aty është bruto siç është pasqyruar në revistën *Studime filologjike*).

Rreth fjalëve të huaja me funksion shpjegues të *Fjalori i gjuhës shqipe*...

shkret *ndf.* pa njeri: mos me e lëshue gjan shkret (pa bari) se bajnë dam (Lumë); e la shkret një gja: **fr. *laisser à l'abandon***; ka mbetë shkret; sh. edhe FGJSH 529.

- Greqishtja, me rreth 640 përqasje. P.sh.:

grym/ë-a *ef.* fr. divergence, **gr. *διχόνοια*** (S. Kolea).

dërmon-i *em.* shoshë me vrima të mëdha, për të shoshur grurin (Opar); përdoret me tepër në lëm, për të ndarë kashtën (me të gjatë se kokrrat) nga gruri; 2. satac. Khs. **gr. *δρομοχί***, it. *gran crivello*.

rrëkëllehem *fm.* bie poshtë: Greqia u rrëkëllëye: ra në dekadence; **gr. *κατέεισε***.

- Gjermanishtja, me rreth 350 përqasje. P.sh.:

arrç,-i *em.* 1. dosëz-a, it. grillotalpa, **gjerm. *Maulwurt***; 2. kacabu, fr. hanneton, it. maggiolino, **gjerm. *Maihäfer***.

ardhun (i, e) *mb., emf.* 1. ardhës, që s'është anas, vendës, po ka ardhur prej një vendi tjetër; i ardhëm; 2. i shkueshëm: burr'i ardhur, djal'i ardhur, fr. traitable, **gjerm. *verträglich***; edhe FGJSH 14⁴.

rrëzë *pf.* punonin tokat rrëzë kodrave; po rrinte rrëzë votrës: **gjerm. *am häurliche Herd setzen***, fr. s'asseoir au coin du feu; rrëzë kasollave.

- Rumanishtja, me rreth 76 përqasje. P.sh.:

acar, acaroj mund të lidhet me **rumanishten a otări**: gjerm. schaudern machen; etimol. e foljes *otări* nuk dihet; ndoshta "acaroj" mund të lidhet me ask ασχ, sh. Boisacq ασχαρίζω.

bardhëz(ë),-a *ef.* një shpend si lejleku, por më i vogël, ibis; khs. **rum. *barzã***: lejlek (e ka marrë ruman. prej shqipes); (S. Kolea) pupë, fr. larve (?)⁵.

rajisht/ë-a *ef.* këmbëz a thembër mali (S. Kolea); fr. contrefort; gjerm. Ausläufer; **rum. *picior***.

- Latinishtja, me rreth 66 përqasje: **asgjâ** *pr.*: e ordhëninë e tinë Zot e batë **asgjâ** pr'ordhënit taj (Buzuku, Matth. XV. 6) **lat. *et irritum fecistis mandatum Dei***: it. avete annullato: e prishtët (Argjir.) nuk e majtët porosinë (Kristof.), gr. ήκυρωσατε; e baj n'asgja.

purtull-i (edhe **pujtull-i** a **pujtull-a**) *em.* një farë druri i ulët; **lat. *listacia lentiscus***.

andërinj *fk.*: andërinj andra (Buzuku, Punët, II 18), **lat. *somnia somnabunt***.

⁴ Përqasja me *Fjalorin e Gjuhës Shqipe* (1954) është bërë nga autorët që e kanë botuar materialin në faqet e SF-së e jo nga A. Xhuvani. Madje në numrat e fundit të revistës gjejmë përqasje me numrat më të hershëm të saj, si p.sh.: **gatërroj** *fk.* ngatërroj, **sh. edhe SF, 1972, 2. 135** (Leake). / **gërryej** *fk.*: pula gërren: pula ngërret // gërrehem *fm.*: ishte gërre populli, fr. s'était épuisé; **sh. edhe SF, 1972, 2, f. 190**.

⁵ Shumë herë në *Fjalor* gjejmë pikëpyetje /?/ - që tregon se vetë A. Xhuvani nuk ishte i sigurt për disa përqasje apo etimologji. Ai nuk arriti ta përpunojë materialin e vjelë.

- Turqishtja, me rreth 14 përjasje. P.sh.:
lundër-a *ef.* katërkëmbësh mishngrënës sa një mace; edhe: vidër-a; **turq. kunduz.**
çetele-ja *ef.* rabush (**turq.:** *çetulla*); FGJSH 65.
praptin/ë-a *ef.* një tokë që s'e rrok dielli mirë, i bie po më një krah; **turq. kibël** (Shpat-Elbasan).
 - Sllavishtja, me rreth 11 përjasje. P.sh.:
ftekem fm. mendohe: **pse fteke:** pse mendohe (Dibër); kujtohem: **fteku** një herë; *m'u ftek të shkoj te miku; më fteket:* më kujtohet: *a të fteket?* (nga **slav. teknuti?**).
lisk/ë-a *ef.* dele me pika, plloça, të kuqe në fytyrë (ose në këmbë), sh. lisk-i (Lumë); dele që e ka turirin të kuq (Mat); mb. dele, dhi liskë: me pikëla të kuqe (Lumë); khs. **liska slav.:** një farë pate e egër.
rraptoj fk. përpjek, përplas, trokas: rraptoj duart, rraptuen duert; sh. edhe rrapas, rrapatem, rrapamë; khs. rum. aropoti; **slav. ruputati, ropotati;** sh. edhe FGJSH 471.
 - E fundit duket se është serbishtja me 10 përjasje: **gavyell-i** (edhe **gavell-i**) *em. shm.* **gavej-t** secila nga katër pjesët e rrethit të rrotës së qerres: *gavyell a gavell* i rrotës; gjerm. *Radfelge*; fr. *jante*; **serb. gobella, naplatak;** edhe FGJSH 137.
gërçak-u *em.* enë, ibrik a shtambë uji prej balte (Kosovë); nga **serb. krčag;** gjerm. *Krug*.
lutrâ mb. i fortë fort: alamet lutranit nga **serb. ljuta.**

- Është e dukshme që përjasjet me gjuhët e tjera janë të shumta. Po si paraqiten këto në këtë fjalor? Për të analizuar këtë, kemi marrë në shqyrtim përjasjet e bëra nga autori me gjuhën frënge, të cilat në Fjalor nuk janë të pakta. Konkretisht, do të hetojmë fjalët ku na jepet barasvlerësi i fjalës shënuese, fjalët me përjasje të pjesshme të shpjegimit në frëngjisht, përkthim të shembullit, raste kur fjala jepet me një shprehje frazeologjike, me një varg sinonimesh, barasvlerës të shprehjes frazeologjike apo përkthim të përkthimit të shprehjes frazeologjike. Le t'i shohim me radhë këto raste.
- Raste ku na jepet barasvlerësi i fjalës shënuese:
afërsinat *shm.:* viset e afërta, fr. *les alentours*, FGJSH 3: vendet aty afër, vendet rreth e rrotull një qyteti. (**afërsinat** > *les alentours*)
ajk/ë,-a; 1) **ajka** e *qumështit:* lyra: **ajka** e *leshit*; 2) pjesa e zgjedhur, fr. *élite*: **ajka** e *burravet.* (**ajka** > *élite*)
anepjesë,-t *ef., shm.* gjërat e dorës së dytë; fr. *les accessoires* (**anepjesë** > *les accessoires*)
 - Raste me përjasje të pjesshme të shpjegimit në frëngjisht:
aradhë *ef.:* ...të të martonj me ndonjë çupë të **aradhës** tënë: fr. *de notre condiction* (Dozon 65) (të **aradhës** tënë > *de notre condiction*)

Rreth fjalëve të huaja me funksion shpjegues të *Fjalori i gjuhës shqipe...*

bor/ë-a ef.: bora binte fije-fije, si fjolla mëndafshi; bora binte **suklla-suklla**: fr. *à flocons* (S. Kolea); floku i borës (**suklla-suklla** > *à flocons*)

- Përkthim të shembullit: **arrëz,-a** ef. arzë, rrotulla e parë e qafës mbi të cilën mbështetet koka: ia dreth arrëzën: fr. *je donne le coup de puce*; FGJSH 18 (ia dreth arrëzën > *je donne le coup de puce*)

arrakat mb. qis, bëj **arrakat**, fr. *faire dégénérer*, abâtardir; dal, bëhem **arrakat**, se *dégénérer* (S. Kolea) (qis, bëj **arrakat** > *faire dégénérer*, abâtardir; bëhem **arrakat** > se *dégénérer*)

e la më nj' **anë**: s'u kujdes më, fr. *abandonner* (e la më nj' **anë** > *abandonner*)

bëhem me të, mbështes mendimin, qëndrimin e tij, fr. *prendre parti* (pour quelqu'un).

- Me shprehje frazeologjike: shef **andra në diell**; shef **andrra kuajsh: rêves de fièvres**.

i bâhem barrë (ndonjërit): e mërzis, e bezdis, fr. *être de charge à quelqu'un*.

bashkë ndf.: **bahem bashkë**: bëhem njësh, fr. *aller d'accord*.

...**shkoi me bisht ndër shalë**: iku i turpëruar, it. *partire umiliato da un luogo, andar via umiliato e confuso, scapare, mettersi la coda tra le gambe*; gjerm. *mit eingeziogenen schwange*; fig. *kleinlaut geworden, beschämt*; fr. *perdre son aplomb*; rum. *cu coada între picioare* (në këtë rast frazeologjia na është dhënë edhe në italisht, gjermanisht dhe rumanisht).

ai bëhet copë për ne: fr. *il se met en quatre pour ngus*.

- Me varg sinonimesh: **çelur (i, e)** mb. 1. i gëzuar, i qeshur, i kënaqur; fr. *gai, joyeux, fleuri, fleurissant*, gjerm. *blühend*; i çilun (Shkodër); 2. i çiltër, i sinqertë; fr. *ouvert, sincère*; gjerm. *geöffnet*.

gatëri-ja (edhe **ngatërri-ja**) ef. ngatërri, çarravi, fr. *confusion, désordre, embronillement* (Çam. Kull. Lek 312).

fryj fk. e **fryj** berrin nga kambët; *ma parë s'frynin barkun me bukë*; i **fryn** zjarrit (edhe rum. *a sufla in foc*); i **fryj** fyllit burisë; **fryj** hundët (qyrrat); *me i fry kujt në vesh*, fr. *souffler à l'oreille de qc, insinuer, rapporter secretement*; ...

- Barasvlerës të shprehjes frazeologjike me një fjalë të vetme:

buell-i em.: nuk shpëton sikur të hysh në bir të buellit: nuk shpëton në asnjë mënyrë; mos e bân mizën buell: mos e tepro, fr. *n'exagère pas* (mos e bân mizën buall > *n'exagère pas*).

- Përkthim të shpjegimit të shprehjes frazeologjike:

vë në **bukë**: **i jep punë**, fr. *lui conférer des emplois, lui procurer un emploi, caser quelqu'un*.

Përqasjet, përveç të mirave që kanë (del më i qartë shpjegimi i kuptimit të një fjale), shoqërohen edhe me probleme.

Problemi i përqasjeve me frëngjishten në Fjalor

Në Fjalorin e pasqyruar në numrat e revistës janë gjetur raste pasaktësie në drejtshkrimin e fjalëve nga frëngjishtja, gjermanishtja, italishtja dhe greqishtja. Përvoja e punës tregon se ka mjaft gjasa që kjo nuk ka të bëjë me punën e prof. A. Xhuvanit, apo të profesorëve M. Domi dhe Q. Haxhihasani. Mund të jenë gabime daktilografimi, si dhe probleme që lidhen edhe me normën drejtshkimore të evoluar. Sot teknologjia kompjuterike vjen në ndihmë të madhe, sidomos për gjuhët që kanë autokorrektim shumë të saktë, siç është rasti i gjuhëve të mësipërme. Autokorrektimi i tyre na jep dorë të kuptojmë nëse ka gabime drejtshkimore ose na shtyn të dyshojmë për saktësinë e përqasjeve. Do të jepen për ilustrim disa raste që janë ndeshur në punën tonë gjatë hedhjes në kompjuter të të gjithë lëndës leksikografike. Më konkretisht, janë zgjedhur këto përqasje nga frëngjishtja⁶:

sy-ri, sy-ni, sy-u em. ...hap sytë: kij kujdes, gr. πρόσεξε, it. fare attenzione, fr. *faire attention*: ...

...fr. *aspire* à, sh. edhe më qan zemra për...,

...fr. *avoir égard, être bienveillant envers auelqu'un, avoir de bonnes intentions à l'égard de quelqu'un*; e marr me sy të keq; e shof me sy të keq; nuk më pëlqen; e vështroj me qëllim të keq; këtë gjë nuk do ta shofi me sy të mirë ai: nuk do ta përkrahë, i hyj më sy dikujt, fr. *acquèni* son faveur;

Pra, siç duket qartë në shembullin e mësipërm, shkronja *t* është shkruar *l: attention > attention* (shembujt e mësipërm janë marrë nga fjala **sy**).

enver (mungon një -s – *envers*); *intentins* (mungon një o – *intentions*); *aspire* à (në vend të -s fundore duhet një -r, pra *aspirer* à); *acquèni* (në vend të -ni duhet -rir pra *acquérir*).

Ka luhatje edhe brenda për brenda vetë një shpjegimi. P.sh.: *aequ'un > quelqu'un* – Apo: > *qc* te: *me i fry kujt në vesh*, fr. *souffler à l'oreille de qc*,... – gjë që të bën të kuptosh që janë gabime daktilografimi e jo “lapsuse” të autorit.

Probleme të tilla ka edhe në gjuhët e tjera, por për këto do të punohet në një fazë të mëvonshme me ndihmën e specialistëve të gjuhëve përkatëse.

Çështja e drejtshkrimit të fjalëve të huaja është një nga problemet që kemi hasur në këtë Fjalor. Një tjetër problem që është vënë re, lidhet edhe me mospasqyrimin në revistë të disa përqasjeve me gjuhët e tjera. Nuk dihet përse janë lënë jashtë këto përqasje. Ky problem doli gjatë një konfrontimi që i bëmë lëndës së Fjalorit në faqet e revistës *Studime filologjike* dhe lëndës që gjendet në Kartotekën e Leksikut të Shqipes, konkretisht të shkronjës **M**. Vumë re se disa përqasje me gjuhët e tjera mungonin. Më poshtë po japim disa

⁶ Shembuj pasaktësie ka shumë. Kemi përzgjedhur disa që na janë dukur më pertinentë.

Rreth fjalëve të huaja me funksion shpjegues të *Fjalori i gjuhës shqipe...*

nga këto mungesa (të shënuara me germa të theksuara me ngjyrë të zezë dhe shkrim të pjerrët):

mitra: manez t'egra (**malina, serbisht**).

moritunë (i, e) *mb.* 1. i vogël, i dobët nga trupi, i lijët, i pafuqishëm; **fr. exigü, petit**; 2. i pakët: ndimë e moritunë.

mulli-ri, mulli-ni *em.*: flet si mullini pa ujë; fjalë shumë në mulli: **it. si dice di chi non smette mai di parlare (Leotti)** (për një që flet shumë e pa vend), khs. rum. a indrugă ca la moară, fr. dire des choses en l'air; shiti në mulli ato: mos m'i thuaj mua.

Përfundime

Aleksandër Xhuvani punoi me dashuri e pasion të veçantë për mbledhjen e fjalës shqipe, punë, të cilës i kushtoi gjithë jetën e tij. Në këtë kuadër, synimi i tij ishte hartimi i një fjalori të shqipes nën shembullin e veprës së K. Kristoforidhit. Fatkeqësisht përpjekjet e tij, nuk arritën të kurorëzoheshin me realizimin e kësaj vepre, pasi A. Xhuvani nuk pati kohën e mjaftueshme dhe për rrjedhojë, ai nuk mundi të shkojë përtej fazës së parë, asaj të regjistrimit fillestar të materialit. Ky stad nuk e lejoi atë të kalonte në fazën e përpunimit dhe sistemimit të lëndës që ai arriti të mbledhë.

Ky kontribut i madh i gjuhëtarit të njohur u bë pronë e publikut të gjerë falë punës e përkujdesjes së veçantë të dy studiuesve të tjerë të shquar, Mahir Domit e Qemal Haxhihasanit, të cilët e botuan pasurinë e A. Xhuvanit në faqet e revistës *Studime filologjike*.

Ky botim, i cili është pasuruar më vonë me gjetjen e një pjese të konsiderueshme të materialit që nuk figuronte në faqet e kësaj reviste, pavarësisht disa mangësive, ka vlera shumë të mëdha në kuadrin e korpusit leksikografik të shqipes në përgjithësi e sidomos për mënyrën e trajtimit të tij në veçanti.

Do të veçonim si një vlerë të Fjalorit, punën shembullore që ka bërë A. Xhuvani në shpjegimin e kuptimit të fjalëve dhe përjasjen e tyre me ekuivalentin përkatës në disa gjuhë të huaja.

Nga puna që kemi bërë me Fjalorin e A. Xhuvanit, janë evidentuar mjaft gabime drejtshkrimore për sa i përket përjasjes me gjuhët e huaja, të cilat synojmë t'i eliminojmë duke iu drejtuar fondit të pasur të Xhuvanit. Mëtimi është që të sjellim gjithçka me vlerë nga puna e bërë nga profesor Aleksandër Xhuvani me fjalën shqipe e kuptimin saj, për t'i dhënë kështu jetë ëndrrës së tij dhe për të përmbushur gjithashtu një detyrim që ia kemi borxh këtij personaliteti të madh të shkencës sonë.

